



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA



Njoftim

Zyra e Regjistrimit të Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në bashkëpunim me komunat e Kosovës

Shpallë konkurs për pranimin e:

Kontrollorëve

Kërkohej një numër i caktuar i personelit në pozitën e kontrollorit që do të angazhohen në projektin e Regjistrimit të Popullsisë. Aplikuesit për këtë pozitë duhet ti plotësojnë kriteret të cilat janë të specifikuara në konkurs.

Informatat mund ti merrni edhe në web faqën zyrtare të Entit të Statistikës së Kosovës <http://esk.rks-gov.net> lidhja (**Rekos 2011**), në ueb faqet e komunave si dhe në të gjitha komunat e Kosovës (objektet komunale). Konkursi është i hapur nga 07 shkurt 2011 deri 18 shkurt 2011.

Aplikacionet mund të shkarkohen (merren) në web faqen e ESK në adresën: <http://esk.rks-gov.net> apo mund të merren në formë të shtypur në kuvendet komunale.

Aplikacionet dorëzohen-pranohen deri më datën 18 shkurt, ora 15:00, në ndërtesat e kuvendeve komunale në formë të shtypur. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në objektet e komunave përkatëse.

Numrin e përgjithshëm i kontrolloreve që do të pranohen në një komune mund ta merrni në komunën tuaj.

KONKURS PER PRANIMIN E KONTROLLORËVE NË PROJEKTIN E REGJISTRIMIT TË POPULLSISË NË KOSOVË

Kriteret :

Të gjithë kandidatet e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e mëposhtme mund të aplikojnë për punën e kontrollorit në projektin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë :

1. Të jetë banor i Kosovës, dhe të paraqitni dëshmin e identitetit
2. Të ketë reputacion të mirë dhe të mos të jetë nën hetime
3. Të ketë kualifikim univerzitar apo shkollen e lartë, përjashtohen nga ky kriter personat të cilët kanë përvojë në shërbime statistikore
4. Të jetë banorë i komunës ku pjesa më e madhe e detyrave është e percaktuar
5. Të ketë aftësi për të folur dhe kuptuar bisedat normale në më së paku njërën prej gjuhëve të kërkuara në konkurs (ju lutem përcaktoni gjuhët të cilat i flisni)
6. Të jetë i gatshëm të merr pjesë në sesionet e trajnimeve dhe të ketë aftësi trajnimi dhe kontrolli për punën e regjistruësve.
7. Të jetë i lirë nga secila punë obligative për tërë periudhën e caktuar në regjistrim
8. Të posedoj një telefon mobil
9. E preferuar, të ketë leje për vozitje
10. Të jetë i gatshëm për punë me orar të zgjatur të punës, të punojë edhe gjatë ditëve të vikendit

Nuk merren në shqyrtim aplikacionet e kandidateve të cilët:

- Janë të angazhuar në veprimtari të partive politike gjatë kohës së kryerjes së detyrës në regjistrim në periudhën brenda 24-orëve.
- Janë të punësuar si vlerësues i tatimeve, kontrollor i tatimeve apo oficer i zbatimit të ligjit

Detyrat dhe përgjegjësit

Kandidatet të cilët arrijnë të përzgjidhen për punën e kontrollorit, ata do të trajnohen nga mbikëqyresit e tyre. Pastaj kontrolloret do të mbajnë trajnime për regjistruësit që do të kenë në përgjegjësinë e tyre regjistruësit do, të mbështetin/ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave të kryer nga ana e regjistruësve, të pajisin regjistruësit me materialet e regjistrimit dhe të sigurojnë udhëheqësit/mbikëqyresit pyetësorët e plotësuar dhe të kontrolluar.

Si shtesë, ju duhet të jeni në dispozicion për së paku 10 ditë pas përfundimit të regjistrimit (data e vlerësuar e përfundimit të detyrës suaj është 25 Prill 2011).

Ju po ashtu do të jeni të ngarkuar për kontrollin e cilësisë të punës së kryer nga regjistruesit.

Gatishmëria në kohë dhe saktësia janë shumë me rëndësi në punën e kontrollorit, në përmbushjen e standardeve të regjistrimit. Po ashtu në vargun e detyrave tuaja është se ju do të ri-intervistoni disa prej ekonomive familjare për të siguruar se regjistruesit kanë regjistruar përgjigjet saktësisht.

Kohëzgjatja e punës

Punësimi do të zgjasë 1.5 muaj nga 10 Mars-25 Prill 2011

Puna, Orët dhe Pagesa

Puna ditore e regjistrimit zakonisht kryhet brenda orarit prej 08:00 deri 20:00. Rregullisht gjatë procesit të regjistrimit, ju duhet të punoni më vonë me qëllim të grumbullimit dhe kontrollimit të punës ditore të regjistruesve. Për të plotësuar afatet, regjistruesit tuaj duhet të jenë në dispozicion të punojnë kur personat që përgjigjen janë në shtëpi. Jeni të gatshëm për të qenë të zënë/ngarkuar veçanërisht gjatë vikendeve

Ju do të paguheni në bazë të punës që mbuloni për atë periudhë. Pagesat mbulojnë trajnimin tuaj, trajnimin që ju e mbani për regjistruesit, punën e kontrollimit gjatë regjistrimit dhe periudhën e pas-regjistrimit të kontrollimit të pyetësorëve dhe hartimin e formave përmbledhëse. Ju po ashtu do të merrni kompensim të udhëtimit.

Paga baze mujore do të jetë 400 euro.

Trajnimi

Ju do të trajnoheni nga mbikëqyrësit tuaj për 5 ditë (nga 14 deri 18 Mars 2011) dhe ajo do të mbahet në komunën tuaj. Nga 21 deri 25 Mars 2011 ju, së bashku me 3-4 kontrollor tjerë dhe me mbështetje të Instruktorit shtetëror, do të trajnioni një grup rreth 25 regjistrues.

Dy ditë para fillimit të regjistrimit (29-30 Mars 2011), ju do të siguronit trajnim praktik në rajonin tuaj të caktuar për regjistruesit tuaj të caktuar (rreth 6 persona). Ju po ashtu do të ndihmoni regjistruesit tuaj për të interpretuar dhe azhurnuar hartat e territorit të tyre. Gjatë trajnimit nga ana e udhëheqësve, ju do të pajiseni me një udhëzues, një hartë të territorit/zonës të caktuar, si dhe materiale të tjera të regjistrimit .

Komisioni Komunal i regjistrimit është një punëdhënës me mundësi të barabarta.